REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr 4035 **Prot** **Maliq më** 04 /09 **2024**

Njoftim

Drejtuar :Nën/Kryetarëve :.Z.Eridjon Rustemi,Z.Florenc Tabaku

Sekretar i Pergjithshem : Jonila Xhialli

Drejtues dhe specialistë :Almira Muka ,Jona Grabocka,Enkelejda Jonusllari,Astrit Zholanji , ,Arben Dulellari ,Azem Nuhu ,Genci Floqi ,Kastriot Malushit,Ardian Goroveci,Klarsen Brako,Ermanda Petriti,Matilda Shaholli.

Më datë 11.09.2024 ora : 10:00 Njësia Administrative Pirg

ora : 12:00 Njësia Administrative Vreshtas

ora 14:00 Bashkia Maliq Qendër

Më datë 12.09.2024 ora : 10:00 Njësia Administrative Libonik

ora : 12:00 Njësia Administrative Pojan

Më datë 13.09.2024 ora 10:00 Njësia Administrative Gorë

ora 12:00 Njësia Administrative Moglicë

Do të kryhen dëgjesa publike me komunitetin ,bizneset,kryetarë fshatrash dhe keshilltarë për përgatitjen e projekt- dokumentit të rishikuar të PBA-së 2025-2027 dhe buxhetin e vitit 2025, duke paraqitur shërbimet që kryhen bashkia ndaj komunitetit dhe investimet prioritare për tre vitet në vazhdim .

Ana Gora (koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik)do të mbajë procesverbalin e takimeve .

Lutemi respektoni orarin .

Faleminderit !

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr 4036 **Prot** **Maliq më** 04 /09 **2024**

Lënda : Organizimi i seancave dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit për PBA-në e rishikuar 2025-2027

Drejtuar : Njësive Administrative të Bashkisë Maliq , Strukturave në Bashki .

Në zbatim të ligjit 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore "neni 36,37 dhe 38 dhe Udhezimit nr 3 date 28.02.2024"Per pregatitjen e PBA-se vendor 2025-2027" pika 32,ju njoftojmë organizimin e takimeve konsultative me të gjithë aktorët e interesuar duke përfshirë banorë nga të gjitha njësitë administrative,administratorët,kryetarët e fshatrave,përfaqësues të bizneseve të zonës,përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile,gazetarë,media lokale etj, për projekt dokumentin e PBA-së të rishikuar dhe buxhetin e vitit 2025.

Seancat dëgjimore do të bëhen të hapura ku do të ketë pjesëmarrje nga të gjithë grupet e interesit.

Nga kryetari i Bashkisë dhe drejtues të tjerë do të prezantohen aktiviteti i bashkisë për këtë vit buxhetor krahasuar me dy vitet më parë , prezantimi i PBA –së të rishikuar 2025- 2027 si dhe buxheti i vitit 2025,investimet prioritare sipas njësive administrative ,shërbimet që kryhen nga bashkia (pasi kostoja e tyre përcakton dhe nivelin e tarifave).

Proçes-verbalet e takimeve së bashku me qëndrimet , sugjerimet , vërejtjet e komunitetit do të jenë pjesë e dokumentit të PBA –së të rishkuar 2025-2027.

Takimet në Njesitë Administrative Pirg,Vreshtas e Maliq do të kryhen ditën e merkure datë 11.09.2024, Libonik e Pojan ditën e enjte datë 12.09.2024 , diten e premte date 13.09.2024 Gorë e Moglicë .

Administratorët do të konfirmojnë vendin dhe orën e takimit .

Merrni masa qe të kemi pjesëmarje nga të gjitha grupet e interesit dhe takimet të jenë sa më efektive .

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT PUBLIK

Nr._____Prot. Maliq, më 06.11. 2024

INFORMACION RRETH NJOFTIMIT

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për projekt-dokumentit të rishikuar të PBA-së për vitet 2025-2027 dhe buxhetin e vitit 2025 u bë më datë 04.09.2024, njoftimi me nr. 4035 prot.. njoftimi u publikua në faqen ëeb të bashkisë Maliq, (https://bashkiamaliq.gov.al/ëp-content/uploads/2024/09/Adobe-Scan-6-Sep-2024.pdf), si dhe në faqet e facebook të bashkisë Maliq (https://ëëë.facebook.com/share/p/ëëN17j7kM2vd5y3/) dhe Këshillit Bashkiak. Po ashtu njoftimi u është dërguar njësive adimistrative dhe kryetarëve të fshatrave.

KONSULTIMI PUBLIK

Duke u bazuar në ligjin nr. ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i cili ndër të tjera ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin nga autoritetet lokale, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara të politikëbërjes dhe vendimmarrjes bë nivel lokal, duke ndikuar kështu në zhvillimin e politikave të qëndrueshmë ne interes të përgjithshëm. Bashkia Maliq, në bashkëpunim me njësitë administrative, si dhe me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave mbajtën konsultim publik për projekt-dokumentin e rishikuar të PBA-së, për vitet 2025-2027 si dhe konsultim publik për buxhetin e vitit 2025.

Konsultimi publik u krye në sallën e Këshillit të Bashkisë Maliq, me kryepleqtë e fshatrave.

Më poshtë janë të paraqitur procesverbalet e mbajtura në çdo njësi sipas problematikave që u hasën.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 05.11.2024, ora 14:00, në Bashkinë Maliq, qyteti Maliq, ku u zhvillua dëgjesa publike me temë "*Projekt-buxheti i vitit 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025*".

Konsultimin e kryesuan:

- Kryetari i bashkisë, z.Gëzim Topçiu;
- Sekretari i Përgjithshëm, znj. Jonila Xhialli

Të pranishëm nga ekzekutivi i bashkisë ishin:

- Drejtor i Drejtorisë së Të Ardhuarave, znj.Jona Grabocka;
- Nënkryetari i bashkisë, z.Eridjon Rusetemi;
- Drejtor i Drejtorisë së Ujitje-Kullim, z.Astrit Zholanji;
- Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, zArben Dulillari;
- Drejtor i Drejtorisë së Rrugëve Rurale, z.Ardian Goroveci.

Të pranishëm nga pjesët përbërsë të komunitetit:

- Drejtor i shkollës 9-vjeçare Maliq;
- Drejtor i gjimanzit të Maliqit;
- Këshilltar, z.Faslli Zholi;
- Këshilltar.

Po ashtu, të pranishëm në këtë konsultim publik ishin dhe kryetarët e fshatrave.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin 55 (pesëdhjetëepesë) persona

Takimi hapet nga Kryetari i Këshillit të bashkisë z.Ornildi Demollari

Kryetari i Këshillit Bashkiak Maliq, z. Ornildi Demollari: Të nderuar pjesëmarrës ju falenderoj që jeni sot këtu në këtë takim konsultativ dëgjimor sicc janë konsultimet me publikun i cili organizohet në kuadër të përgatitjes së projekt-buxhetit afatmesëm të harkut kohor 2025-2027. Konsultimi publik i ditës së sotme organizohet nga Këshilli i bashkisë, si detyrim ligjor sepse e kemi detyrim përpara se të vijë momenti i hartimit të projekt-buxhetit ne duhet të kemi marrë mendimet dhe rekomandimet e komuniteit dhe si detyrim ligjor, në bashkëpunim të ngushtë me ekzektivin kemi organizuar këtë takim konsultativ ose dëgjimor. Dua t'u falenderoj të gjithëve, dua të falenderoj veccanërisht administratën, kryetarin e bashkisë dhe të gjithë skuadrën që bën të mundur takimin fillimisht dhe më pas zbatimin e projekt-buxhetit, që nga performanca e të ardhurave, drejtoria juridike e të tjerat me radhë, të cilët bëjnë të mundur hartimin dhe zbatimin e projekt-buxhetit. Ky takim është organizuar në formë të tillë pasi është takim diskutimi, pasi e hapim, është takim diskutimi ku ne, ose komisioni i jonë i finacës i këshillit merr rekomandimet tuaja dhe rekomandimet e komunitetit për t'i pasur parasysh dhe për t'i reflektuar pastaj në projekt-buxhetin e harkut kohor 2025-2027. Prandaj Petriti si kryetari i komisionit të financës së këshillit është këtu pranë nesh. i cili do të marrë fjalën ndoshta pas kryetarit të bashkisë.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Mund të them vetëm dy fjalë, në fakt ne këtë proces e kemi realizuar në ccdo njësi administrative, me aktorë të ndryshëm, edhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të këshillit, si të mazhorancës dhe të opozitës. Kemi marrë shqetësimet, mendimet edhe jo vetëm kaq, por nga kryetarët e fshatrave, veccanërisht kemi kërkuar një informacion në një letër për atë që ata kanë shqetësim dhe ne mund ta realizojmë. Mendimet e tyre ne i kemi të hedhura në letër, i kemi evidentuar për ccdo fshat dhe njësi, sipas shqetësimeve që kanë ngritur do ja vemë në dispozicion këshillit dhe në mbledhjen e këshillit por edhe gjatë vitit buxhetor në

zbatim. Megjithatë si dëgjesë publike, si dëgjesë që këshilli i bashkisë realizon për efekt të projekt-buxhetit, ne si ekzekutiv sot jemi dëgjues. në konceptin tim, sepse ne i kemi marrë shqetësimet tona do ja bëjmë prezent këshillit. Jemi ende në hapat e hapa të hartimit të buxhetit sepse edhe ne nuk kemi filluar. Sapo kanë dalë shifrat e para të miratuara në qeveri për buxhetin 2025 sipas sektorëve, sipas transfertave, sipas asaj ccka ne na ccelet. Të themi se 99%, ato shifra do të na vinë dhe ne. Dhe ne sot pothuajse kemi filluar punën, që nga hartimi i llogaritjes së fondpagave, shpenzimet, etj. Riorganizimi i ri që po i bëjmë bashkisë do të thotë që ka një punë shumë të madhe për ne, sepse do të fillojmë disa hapa të tjera, tani do të ndajmë buxhetin në dysh. Një pjesë do të jetë për ekzekutivin dhe një pjesë do të jenë për agjencinë e shërbimeve dhe kjo kërkon një goxha punë të madhe prej nesh, një strukturim të pagave tona.

Megjithatë ne kemi ardhur t'u dëgjojmë, të dëgjojmë dhe anëtarët e këshillit, dhe komisioni e financës, dhe kryetarët e fshatrave apo dhe persona të tjerë të interesuar, drejtorë shkollash ose qendrat shëndetësore. Nuk e di si e ka organizuar këshilli i bashkisë por ne jemi gatu t'u dëgjojmë dhe për të ndërthurur apo dhe për ë rakorduar veprimet deri sa buxheti të marrë formën përfundimtare të një projekti dhe pastaj të një vendimmarrjeje të këshillit të bashkisë. Shumë faleminderit që na keni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike!

Kryetari i Këshillit Bashkiak Maliq, z. Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar. Petrit, vazhdojmë, keni fjalën.

Petrit Kupe, këshilltar: faleminderit të gjithë pjesëmarrësve, ëshilltarëve të pranishëm, kryetarëve të fshatrave, gjithashtu dhe administratës së bashkisë Maliq. Jemi në momentin përfundintar të dëgjesave, pasi sicc tha dhe kryetari ato u zhvilluan në ccdo njësi vendore. Por ky moment ka rëndësi për shërbimet që duhet të kenë prioritet që të plotësohen nga ekzekutivi. Këto dëgjesa do i hapin rrugë mundësisë për hartimin e buxhetit të vitit 2025-2027. Do të doja që pjesëmarrja e këshillit të ishtë më e plotë, të ishin dhe të gjithë kryetarët e fshatrave, duke sjellë kështu më shumë problematika dhe më shumë ide. Tashmë ka nisur të dëgjohet zëri i kryetarëve të fshatrave, zëri i këshilltarëve. Ne si komision ekonomik, krahas propozimeve që ka bashkia, do t'i mbledhim këto sugjerime që ka komuniteti dhe do të kërkojmë që të pasqyrohen në buxhetin e ardhshëm të bashkisë. Atëherë fillojmë konkretisht, të dëgjojmë zërin e gjithsecilit, në përfaqësinë që ka ccdo fshat. Fjalën e keni ju!

Kryetari i Këshillit Bashkiak Maliq, z. Ornildi Demollari: Nëse e do dikush fjalën, për sugjerime, për mendime... po

Faslli Zholi, këshilltar: Përshëndetje të gjithëve! Përshëndetje kryetar, kryetar i këshillit! Ne jemi mbledhur sot në një dëgjesë publike, ndjesë për zërin. Për sa i përket buxhetit që ne kemi ndjekur dhe aktivitetit që bëmë me kryetarin në ccdo njësi vendore, Kjo është për mua një eveniment shumë i rëndësishëm sëpse ka të bëjë me ato që bëjmë ne dhe ccka do të bëjmë. Një problem të cilin dhe banorët kanë nevojë shumë imediate, e rëndësshme për mua do të jetë që ky buxhet të bëhet me poltika dhe të hartohet dhe ndahet ashtu sicc duhet, aty ku bashkia ka nevojë

më shumë. Konkretisht neve kemi disa gjëra imediate për të cilat qytetarët kanë nevojë dhe ne i djëgjuam. Secili nga kryepleqtë ngritën problemet e tyre, edhe këshilltarët po ashtu. Kam një vërejtje për këshilltarët, qoftë të opozitës, qoftë të pozitës, duhet të ishin 100% në këto takime, do ishte gjëja më e mirë. Unë një problem që e kam hasur dhe dëgjuar, qoftë në Libonik edhe dëgjesat e tjera, të cilat ikam ndjekur vet, një problem sa i përket shërbimeve publike, do dal te uji i pijshëm, do dal te kanalizimet, aty pasur parasysh që të kihet parasysh në këtë buxhet se ccfarë do të bëhet më mirë për të rregulluar këto probleme në këto fshatra. Uji është një problem madhor, pasi të gjithë e dimë që pa ujë nuk ka jetë. Tjetër gjë që do të ngre unë këtu, mendoj te ccështja e bujqësisë.

Petrit Kupe, këshilltar: Më konkretisht të lutem!

Faslli Zholi, këshilltar: Do t'i them konkretisht, sepse bashkia Maliq është në drejtim bujqësor dhe konkretisht për mua është që të bëhet, edhe pse punë janë bërë, me ujitjen, me kullimin, nuk dua t'i hedh poshtë, investime janë bërë dhe në infrastrukturë, dhe në rrugë, por një diccka që e njohin të gjithë besoj se është bujqësia. Dhe bujqësia ka të bëjë me prodhimet, këtu duhet gjetur një formulë për tregëtimin dhe shitjen e këtyre prodhimeve. Që do të thotë

Kryetari i Këshillit Bashkiak Maliq, z. Ornildi Demollari: Po flasim për buxhetin e bashkisë o Faslli!

Faslli Zholi, këshilltar: Pikërisht! Në buxhetin e bashkisë duhet të ketë politika, të investojmë dhe t'i ndihmojmë!

Kryetari i Këshillit Bashkiak Maliq, z. Ornildi Demollari: Poltikat e bujqësisë janë politika kombëtare, po flasim për buxhetin e bashkisë sot!

Faslli Zholi, këshilltar: Por jo, ne jemi bashki bujqësore, duhet pasur parasysh!

Kryetari i Këshillit Bashkiak Maliq, z. Ornildi Demollari: Dakord jemi bashki bujqësore, por politikat e bujqësisë në masë më të madhe të madhe bëhen nga qeveria qëndrore, jo nga bashkia.

Faslli Zholi, këshilltar: Për sa i përket arsimit për shembull, investojmë në shkolla dhe nuk ka fëmijë, duhet parë dhe kjo, edhe kjo politikë është. Kështu që lekët duhet të jenë të mirëmenaxhuara, atje ku të jepen, të jepen me efikasitet të plotë për të realizuar atë që duhet bërë. Që të harxhojmë lekë, për x fshat, atje bëhet shkollë dhe s'ka fëmijë, ky është problemi. Po deshe t'i them dhe me emra, se ke qenë dhe vet, ke qenë me mua në disa vende, e në disa vende të tjera s'ke qenë. Kështu këto do desha të thosha, që ka probleme që duhen parë. Në emër të opozitës këro do desha të thosha që duhet parë mirë, qoftë dhe në shëndetësi, qoftë edhe në infrastrukturë. Është bërë punë e mirë por ka vend për punë të tjera. Për ndriccimin, për lekët që paguhen dhe nuk ka shërbim, ka problem. Ka probleme që edhe kryepleqtë i dinë dhe duhet të jenë më aktivë, pasi dhe rritja e pasgës së tyre ka filluar dhe duhet të justfikojnë veten e vet. Nul

duhet t'ja lenë koordinatorëve apo kryetarit të bashkisë se janë ccështje të cilat zgjidhen dhe nga ata. Faleminderit, kaq kisha!

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Kryetar më fal! Dua ta kanalizoj pak situatën. Në takimet që kemi pasur në njësitë administrative kemi ngritur shumë shqetësime, nga më elementaret, si mungesa e një llambe apo mungesa e një tubi diku, deri në investime të rëndësishme që mund të ketë nevojë një fshat. Nga të gjitha dëgjesat që kemi bëë i kemi kanalizuar një pjesë të tyre sipas drejtorive përkatëse. Grupi i punës që kam pasur me vete kanë marrë shënimet përkatëse dhe një pjesë të problematikave i kemi adresuar për t'u zgjidhur. Ndaj që mos të bëjmë të njëtjat diskutime që kemi bërë më herët në njësitë administrative, pasi do të humbasim kohë dhe s'do arrijmë dot të zgjidhim gjë, mendoj që ccdo kryetar fshati të ngrejë një shqetësim madhor për fshatin e vet. Pra problemi që ka radhë prioritare për t'u zgjidhur dhe ne ta kemi parasysh në buxhet dhe ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Maliq, z. Ornildi Demollari: Atëherë fillojmë me kryetarin e fshatit Libonik.

Kryetari i fshatit Libonik, z. Valter Talka: Përshëndetje! Jam kryetar i fshatit Libonik, për sa i përket atyre që tha z. Faslli Zholli, nuk dua të bëj replikë por në fshatin tonë problemet janë evidentuar. Problemi kryesor i fshatit tonë është shtrimi i rrugës së shkollës.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Ke mungesë informacioni, rruga e shkollës fillon shumë shpejt asfaltimi. Është problem i zgjidhur, jemi të larë për vitin 2025. Do të ta zgjidhim që në vitin 2024.

Faslli Zholi, këshilltar: Dua të ngreh dhe shqetësimin e Qendrës Shëndetësore, duhet rikonstruktuar.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: E kemi filluar dhe këtë investim, është projekt nga "Gjysmëhëna e kuqe". Drithasi është sot?

Petrit Kupe, këshilltar: Është dhe pjesa e kanalizimeve në fund të fshat Drithas, pjesa fundore. Këto janë regjistruar nga dëgjesat e bëra heët e kaluara.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Po është pjesa fundore e kanaleve të ujërave të zeza që dalin nga Maliqi, është problem dhe ne kemi menduar ta financojmë me fonde të Ambasadës Sllovene, është projekt i miratuar dhe po presim financimin e tij.

Petrit Kupe, këshilltar: Në Drithas janë bërë shumë punë por rrugët e parcelave janë në gjendje shumë shumë të keqe, kërkohet një ndërhyrje e tyre. Nuk e di në njësitë e tjera por fusha e Drithasit ka shumë probleme. Tjetër problem që ka të bëjë edhe me Drithasin Poshtë, edhe me Vloccishtin edhe me Libonikun është zgjerimi i sipërfaqes së varrezave. Gjithashtu keni dhënë fjalën kryetar për ndërtimin e një trotuar nga Kryqëzimi i Libonikut deri në Drithas Poshtë, është

problem emergjent pasi është rrugë nacionale dhe është shumë e rrezikshme për këmbësorët, gati ccdo muaj ka aksidente. Duhet gjetur një mënyrë financimi pasi është shumë emergjente.

Kreytar i fshatit Vloccisht, Bardhyl Ccami: Përshëndetje të gjithëve, jam kryepalk i fshatit Vloccisht. Në lidhje me ujin e pijshëm kisha një problem, nuk kemi shkarkues, tubat mbledhin dhe duhet shkarkues. Për sa i përket bujqësisë, shqetësim ngelen bagëtitë e imta, ka fermerë të pa përgjegjshëm që futen në pronat e të tjerëve. Problem tjetër është dhe rruga lart, pa asfaltim dhe kanalizim të ujërave të zeza. Problem tjetër kemi dhe dëmtuesit që janë minjtë e arrave, ka shumë dëm. Dhe e fundit si kryetar fshati që jemi nuk kemi një ambient për tu mbledhur dhe për të diskuat për problemet e fshatit, na ngeli vula në xhep. Fshati im është fshat i madh dhe ka shumë komunitet.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Unë mendoj të shikoni ndonjë ambient, ta merrni e qira dhe të shfrytëzohet nga mosha e tretë, nga pleqtë, në përiudha dimri sidomos. Gjithsesi faleminderit për shqetësimet.

Banor i zonës: Kisha diccka në lidhje me Drithasin Poshtë dhe Vloccishtin, aty duhet parë me shumë prioritet kanalizimi i ujërave të zeza për të gjitha ato familje. Dhe e dyta përderisa u bë lidhja e Drithasit Poshtë me Vloccishtin është shumë e rëndësishme pasi është shumë i dëmtuar ky segment rrugor.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Jam në dijeni, është një investim që kërkon goxha investim do përpiqem me ARRSH-në, pasi kam menduar dhe një investim të rrugës deri në Pyllin e Fazanëve. Kurse për Drithasin dhe me ccdo fshat tjetër, problemi i kanaleve të ujërave të zeza është një minë me sahat për komunitetin. Nuk duhen shumë fonde, janë projektet më të lira krahasimisht me projektet e tjera por problemi është se ku do i ccojmë këto ujëra të zeza? Ujëra te zeza që nuk i trajtojmë nuk duhet të kërkojë asnjë, ndaj jemi duke aplikuar për një projekt për blerjen e një mjeti për tërheqjen e ujërave të zeza, nëse nuk e realizojmë dot do përpiqemi ta blemë me fondet tona. Dhe nuk duhet ta lejojmë njëri-tjetrin t'i nxjerrim ujërat e zeza ku të mundim sepse nuk ndotim vetëm shtëpinë e tjetrin por edhe tokën, prodhimet bujqësore.

Kryetari i fshatit Pocestë, z. Roxhens Zgorani: Përshëndetje! Jam kryetar i fshatit Pocestë, besoj se kjo mbledhje duhet të ishte bërë më parë pasi nuk i njohim këshilltarët dhe as na njohin. Pocesta është një fshat i lënë pas dore në disa drejtime, përvecc pjesës së brendshme të asfaltimeve të fshatit kemi dhe disa probleme që duhet të ndërhyhet direkt. Një është sistemimi i rrugëve të kodrave sipër, fshati i përdor dhe kanë të mbjellat e tyre dhe e kanë burim ekeonomik. Pjesa e rrugëve të parcelave. Kemi dy rrugë kryesore që duhen sistemuar, të paktën me ccakëll dhe ajo që është më alarmante është pjesa që ne kemi dy orë ujë në ditë. Puseta është e parrethuar, nuk e di nëse bëhet dezinfektim apo jo por duhen marrë masa. Kam dhe disa probleme të tjera por në këto duhet të ndërhyhet sa më shpejt. A dhe diccka tjetër, nëse bashkia do të kishte mundësi të ndërynte në rezervuarin e Klocës për të shtrirë disa tubacione në mënyrë që të kishim më shumë ujë edhe për familjet edhe për parcelat.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Ke të drejtë per problemet që ngrite, por të thuash që kemi bërë disa gjëra ndërkohë që ne kemi bërë më shumë investime, kemi bërë shkollën, fshati ka dhe ambulancë, kemi bërë kanalizimet e ujërave të zeza që kemi krijuar dhe probleme me të tjerët, por ua kemi realizuar dhe tani do të fillojmë me asfaltime, ndaj mos thuaj që e kemi lënë pas dore

Koordinatori për të drejtën e informimit publik

A.Firanj

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 bm@bashkiamaliq.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KOORDINATORI I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr._____Prot.

Maliq, më 11.09. 2024

INFORMACION RRETH NJOFTIMIT

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për projekt-dokumentit të rishikuar të PBA-së për vitet 2025-2027 dhe buxhetin e vitit 2025 u bë më datë 04.09.2024, njoftimi me nr. 4035 prot.. njoftimi u publikua në faqen ëeb të bashkisë Maliq, (https://bashkiamaliq.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/Adobe-Scan-6-Sep-2024.pdf), si dhe në faqet e facebook të bashkisë Maliq (https://www.facebook.com/share/p/rwcN17j7kM2vd5y3/) dhe Këshillit Bashkiak. Po ashtu njoftimi u është dërguar njësive adimistrative dhe kryetarëve të fshatrave.

KONSULTIMI PUBLIK

Duke u bazuar në ligjin nr. ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i cili ndër të tjera ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin nga autoritetet lokale, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, duke ndikuar kështu në zhvillimin e politikave të qëndrueshëm në interes të përgjithshëm. Bashkia Maliq, në bashkëpunim me njësitë administrative, si dhe me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave mbajtën konsultim publik për projekt-dokumentin e rishikuar të PBA-së, për vitet 2025-2027 si dhe konsultim publik për buxhetin e vitit 2025.

Konsultimi publik u krye në çdo njësi administrative, sipas datave të përcaktuara:

- Më datë 11.09.2024, ora 10:00 në Njësinë Administrative Pirg;
- Më datë 11.09.2024, ora 12:00 në Njësinë Administrative Vreshtas;
- Më datë 11.09.2024, ora 14:00 në Bashkinë Maliq Qendër;
- Më datë 12.09.2024, ora 10:00 në Njësinë Administrative Libonik;
- Më datë 12.09.2024, ora 12:00 në Njësinë Administrative Pojan;
- Më datë 13.09.2024, ora 10:00 në Njësinë Administrative Gorë;
- Më datë 13.09.2024, ora 12:00 në Njësinë Administrative Moglicë;

Më poshtë janë të paraqitur procesverbalet e mbajtura në çdo njësi sipas problematikave që u hasën.

do na ndihmojë më shumë për t'u ardhur në ndihmë fermerëve dhe për të bërë të mundur çakëllimin e sa më shumë rrugëve të parcelave. Atëherë po bëj një përmbledhje sipas fshatrave dhe më pas flisni ju sipas problematikave.

Në fshatin Podgorie që është dhe një nga fshatrat më të mëdhenj të bashkisë sonë, nuk është se kemi planifikuar ndonjë projekt të financuar me fondet tona si bashki. Por Qeveria Shqiptare do të nisë shumë shpejt një projekt të madh, ku do të kemi një ujësjellës të ri për Podgorien, përfshirë këtu linjë të re për të patur ujë 24 orë. Po mendojmë që me këtë ujësjellës të ketë edhe Vreshtasi. Do ndërhyjmë së shpejti në fshatin Sheqeras me rrjetin e brendshëm. Bregasi ujin e ka të rregulluar.

Në fshatin Bregas do të ndërhyjmë në sistemim-asflatim të rrugëve të brendshme, e më konkretisht rruga që hyn në fshat me tip unaze për të dalë në qendër.

Në fshatin Vreshtas do të nisim nga pallatet në drejtim të Kishnikut. Po ashtu, në Vreshtas po shikoj dhe një rehabilitim sallë me fondet tona për të qenë shumë funksionale.

Në fshatin Sheqeras do të ndërhyj këtë vit me sistemim-asflatim të rrugës së stallave, për ta kthyer dhe në shëtitore, besojmë këtë vit do të ndërhyjmë së shpejti. Kemi hartuar projektin për rehabilitimin e plotë të shkollës së Sheqerasit për të kthyer në një shkollë me standarde. Dhe një projekt që po e mendojmë është rehabilitimi i disa banesave kolektive që janë në hyrje të fshatit Sheqeras. Kemi ndërhyrë në një kanal të ujërave të larta mbrapa shkollës edhe pse ka ende vend për punë pasi s'ka dhënë efektin e duhur.

Këto po përmend telegrafikisht, nuk po hyj në detaje apo investime të vogla që janë bërë. Po ju dëgjoj me radhë për të treguar shqetësimet e fshatit dhe cili shqetësim duhet patur prioritet për t'i dhënë zgjidhje.

Mendoj të nisim nga shëndetësia dhe arsimi dhe më pas me banorët.

Infermiere e QSH Vreshtas: Në Qendrën Shëndetësore të Vreshtasit janë dy problematika që ne hasim, rrethimi i qendrës dhe asfaltimi i rrugës. Edhe pse qendrat qhëndetësore janë me vetëfinancim ne kemi ngecur në këtë pjesë.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: E drejtë, jeni me vetëfinancim, e di këtë shqetësim të rrethimit të qendrës, do ta kemi parasysh. Për sa i takon rrugës ne po mendojmë për ta sistemuar rrugën deri në drejtim të Kishnikut. Ne po punojmë për të gjetur një mundësi për ndërtimin e një qendre shëndetësore në Kopole dhe Kishnik, por nuk e di a plotësohen me personel infermierë.

Infermiere e QSH Vreshtas: Kemi shumë pacientë të këtyre dy fshatrave por për pjesë personeli nuk flas dot me siguri, duhet menduar.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Do ta diskutojmë sërish. Ecim me problematikat e shkollave.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Po keni të drejtë do ta shikoj. Ecim me banorët, jemi në Vreshtas, çfarë problematike kemi aty.

Banor i fshatit Vreshtas: Vreshtasi ka shumë për të bërë, s'ke bërë asnjë punë.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Më vjen keq që mendon kështu, por ky Vreshtas që shikon sot nuk ka qenë kështu, kam nisur që nga asfaltimi i 5 km rrugë dhe më pas nëpër lagje të tij. Sistemime të fshatit dhe rrugëve të tij.

Banor i fshatit Vreshtas: Kërkoj të asfaltohen të gjitha rrugët pasi kur bie shi bëhemi me baltë e kur thahet kthehet në tym.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Do të nis rrugën e dytë dhe kërkoj mirëkuptim nga ju kur të bëjmë dhe prishje të ndërtimeve pa lejë. Kam një propozim me që jemi këtu në fshatin tuaj, kohë më parë mbi fshat ka qenë një kanal shumë i madh, a jeni të gatshëm ta rihapim sërish. Do të jetë nja kanal i ujërave të larta dhe do të shpëtonte fshatin.

Banor i fshatit Vreshtas: Dakord jemi. Më parë nuk kishim lagështi në shtëpi, sot shtëpitë tona janë me lagështi.

Kryeplaku i fshatit Vreshtas: Një problem do të ngre unë, ujin në fusha. Në dimër na mbytet toka e në verë nuk ka pikë uji për të vaditur.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Nëse po flet për toka torfike që digjen aty nuk kemi çfarë u bëjmë. Dikush ua ve flakën. Këtë duhet të gjeni! Ne jemi të gatshëm të pastrojmë çdo lloj kanali dhe kolektor.

Banor i fshatit Vreshtas: Po ashtu kërkojmë shtimin e një depoje shtesë për ujin e pijshëm, me kapacitet më të madh dhe pak më lart.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Nesër do jem në Podgorie me drejtorin e Ujësjellësit dhe do të shikojmë një dritë jeshile edhe për Vreshtasin.

Banor i fshatit Vreshtas: Duhet parë dhe Rruga e Varrezave pasi në ditë me shi bëhet shumë keq.

Banor i fshatit Vreshtas: Kemi dhe një fushë sporti, të rrethohet edhe ajo, edhe sporti duhet. Duhen parë dhe rrugët e fushave. Punë është bërë por duhet edhe më shumë.

Banor i fshatit Vreshtas: Duhet të bëhen porta në kolektor për të pasur sa më shumë vaditje.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Kërkoj të gjejmë një zgjidhje për vaditjen e tokave, duhet një zgjidhje alternative.

Drejtor i Drejtorisë së Ujitje-Kullimit, zAstrit Zholi: Ka dy probleme që duhen ndarë, është pjesa e tokës së fushës, që është pjesa e kënetës që merr ujë nga kolektori dhe për këtë që thotë

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Duhet ta hiqni nga mendja që mund të vaditni me përmbytje, duhet të ndryshoni metodë. Vaditni me impiant pasi nuk kemi gjë në vijë kështu.

Banor i fshatit Podgorie: Kërkoj një kosh mbeturinash pasi përfundojnë duke i hedhur në rrugë dhe sistemim të rrugës se për 200m ka ngelur shumë keq.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Do t'i kem parasysh. Vazhdojmë në Sheqeras.

Banor i fshatit Sheqeras: Ne në fshat problem kemi rrugën kryesore, ndriçimin dhe ujin e pijshëm.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Kemi ndërhyrë në një zonë dhe do rihyjmë në një zonë tjetër, do të asfaltojmë rrugën në drejtim të stallave dhe ujësjellësi do të ndërhyjë tani me rrjetin e brendshëm të ujësjellësit Sheqeras. Dua të ndërhyj dhe në pjesën e pallateve pasi dhe aty ka problem.

Tani kërkoj nga pleqësia të më delegojë problematikat me shkrim pasi të jetë konsultuar me ju dhe ne do i kemi parasysh në buxhetin e këtij viti.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen!

Koordinatori për Konsultimin Publik

Ana GORA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KOORDINATORI I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr._____Prot.

Maliq, më 11.09.2024

INFORMACION RRETH NJOFTIMIT

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për projekt-dokumentit të rishikuar të PBA-së për vitet 2025-2027 dhe buxhetin e vitit 2025 u bë më datë 04.09.2024, njoftimi me nr. 4035 prot.. njoftimi u publikua në faqen ëeb të bashkisë Maliq, (https://bashkiamaliq.gov.al/ëp-content/uploads/2024/09/Adobe-Scan-6-Sep-2024.pdf), si dhe në faqet e facebook të bashkisë Maliq (https://ëëë.facebook.com/share/p/rëcN17j7kM2vd5y3/) dhe Këshillit Bashkiak. Po ashtu njoftimi u është dërguar njësive adimistrative dhe kryetarëve të fshatrave.

KONSULTIMI PUBLIK

Duke u bazuar në ligjin nr. ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i cili ndër të tjera ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin nga autoritetet lokale, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara të politikëbërjes dhe vendimmarrjes bë nivel lokal, duke ndikuar kështu në zhvillimin e politikave të qëndrueshmë ne interes të përgjithshëm. Bashkia Maliq, në bashkëpunim me njësitë administrative, si dhe me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave mbajtën konsultim publik për projekt-dokumentin e rishikuar të PBA-së, për vitet 2025-2027 si dhe konsultim publik për buxhetin e vitit 2025.

Konsultimi publik u krye në çdo njësi administrative, sipas datave të përcaktuara:

- Më datë 11.09.2024, ora 10:00 në Njësinë Administrative Pirg;
- Më datë 11.09.2024, ora 12:00 në Njësinë Administrative Vreshtas;
- Më datë 11.09.2024, ora 14:00 në Bashkinë Maliq Qendër;
- Më datë 12.09.2024, ora 10:00 në Njësinë Administrative Libonik;
- Më datë 12.09.2024, ora 12:00 në Njësinë Administrative Pojan;
- Më datë 13.09.2024, ora 10:00 në Njësinë Administrative Gorë;
- Më datë 13.09.2024, ora 12:00 në Njësinë Administrative Moglicë;

Më poshtë janë të paraqitur procesverbalet e mbajtura në çdo njësi sipas problematikave që u hasën.

Jemi duke rehabilituar dhe pallatin e kulturës "Dhimitër Otgocka", ku shumë shpejt nis faza e dytë, po bashkëpunojmë edhe këtu me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për ta kthyer në një qendër komunitare për qytetin.

Kemi hartuar një projekt të ri për shkollën e mesme të Maliqit, me terrene sportive, palestër dhe kushte më të mira.

Kemi disa rrugica në Bllokun nr.3, mbrapa shkollës 9-vjeçare, kemi rrugën e Qesaratës, ku një pjesë do ta fillojmë që këtë vit dhe shpresojmë të dalë unazë e bukur. Te dyqanet e reja do të ndërhyjmë po ashtu.

Jemi duke hartuar dy projekte për një lagje muze në Bllokun nr. 2, ish-lagjen ruse, për ta kthyer në pedonale dhe në një zonë të aksesueshme, ndoshta mund të ndërhyjmë me disa bashkëpunime për biznese të vogla.

Jemi në mbyllje të rrugës që lidh Maliqin me Gramshin, ka një vonesë por pritet që shumë shpejt të mbyllet.

Kemi një projekt të dytë në zonën ku ka qenë Fusha e Druve për ta kthyer në një park shumë të madh, në një qendër sportive dhe për aktivitete të ndryshme për të gjitha grupmoshat.

Kemi disa rrugica që duhen asfaltuar pasi asfalti që kanë, ka nisur të dëmtohet, por nuk do i lemë pas dore. Do ndërhyjmë që këtë vit në disa zona për asfaltim dhe sistemime.

Le ta kthejmë në diskutim, çfarë problematika keni ju.

Do të bëjmë diçka edhe me shkollën, na pengon numri i vogël i nxënësve. Në Maliq duam të bëjmë dhe një çerdhe

Banore e qytetit Maliqi: Janë disa rrugica të vogla në Bllokun nr.1 që nuk janë asfaltuar.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Po e di, jemi në dijeni, shumë shpejt do të nisim me to.

Banore e fshatit Kolanec: Duhen bërë risa restaurime në çatitë e fshatit.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Ke shumë të drejtë, duam të ndërhyjmë në disa shtëpi dhe kasolle që janë aty.

Në Fshat Maliq nuk ka ngelu më punë pa bërë. Në Kolanec do të vazhdojmë asfaltin nga qendra në drejtim të varrezave për t'i dhënë zhvillim urban zonës.

Banore e Fshat Maliqit: Kryetar jo të gjitha janë bërë në Fshat Maliq. Duhet bërë diçka me shkollën, nuk ka as ujë te shkolla.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Do të bëjmë diçka dhe aty, do të ndërhyjmë dhe në fushën e futboolit.

Në Maliq po rehabilitohet dhe Qendra Shëndetësore dhe së shpejti do të bëjmë një stacion pompimi.

Këshilltar, z.Faslli Zholi: Ju falenderoj që jeni në këtë takim. I dëgjova parafolësit dhe do kërkoja të kishim informacion nga shkollat për numrin e nxënësve. Sa i takon qyeteti, ka pastërti. Dua të ngre disa probleme, një nevojë që ka qyteti është një thertore dhe pazari të ketë një vendqëndrim të rregullt. Nuk është i pozicionuar mirë aty ku bëhet. Po ashtu, kërkoj nga kryetari i bashkisë të bëjë kërkesë për një Zyrë Kadastër në Maliq, që të merren shërbimet në Maliq dhe jo në Korçë. Si dhe të kemi disa mjekë specialistë në fusha të ndryshme.

Kryetari i bashkisë z.Gëzim Topçiu: Ju faleminderit për sugjerimet do t'i kemi parasysh!

DËSHMI NGA KONSULTIMI PUBLIK



	Emër Mbiemër	Profiti	Fshati	Nënshkrimi
41.	Feruza Neziri	Mësuese	Q. Maliq	
42.	Klotilda Vollga	Sanitore	Q. Maliq	
43.	Natasha Shkëmbi	Punonjëse ujësjellësi	Q. Maliq.	
44.	Rubip Shambitaku	vet punëshu		
45.	Marjora Mullymeri	pune		
6.	Alberta Gjurovski			
7.	Verore Domollari			
8.	Arefi Shkembi			
9.	Bekoc Shkëmbi			
10.	Delvina Araju			

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KOORDINATORI I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr._____Prot. Maliq, më 13.09. 2024

INFORMACION RRETH NJOFTIMIT

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për projekt-dokumentit të rishikuar të PBA-së për vitet 2025-2027 dhe buxhetin e vitit 2025 u bë më datë 04.09.2024, njoftimi me nr. 4035 prot.. njoftimi u publikua në faqen ëeb të bashkisë Maliq, (https://bashkiamaliq.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/Adobe-Scan-6-Sep-2024.pdf), si dhe në faqet e facebook të bashkisë Maliq (https://www.facebook.com/share/p/rwcN17j7kM2vd5y3/) dhe Këshillit Bashkiak. Po ashtu njoftimi u është dërguar njësive adimistrative dhe kryetarëve të fshatrave.

KONSULTIMI PUBLIK

